



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:247881

Datë: 14.03.2023

Numri i dokumentit: 04077511

P.nr. 488/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarve A. N. dhe A. T., që dy nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge në bashkëkryerje nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP/II.nr.778/22 të datës 18.11.2022 të pranuar në gjykatë me datën 23.11.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **01.03.2023**, në prani të Prokurorit të shtetit Ramadan Koro si dhe të akuzuarve A. N. dhe A. T., me datën 03.03.2023 mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. N. nga Gjakova, Rr.** . . ., data e lindjes . . ., i biri i V. dhe nënës L. e gjinisë Gj., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, me numër personal . . ., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **A. T., nga Gjakova, Rr.** . . ., data e lindjes . . . në Gjakovë, i biri i S. dhe i nënës C. e gjinisë D., ka të kryer shkollën e mesme, mekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, me numër personal . . ., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J a n ë f a j t o r

Sepse :

-me datë 03.05.2022 rreth orës 00:10 minuta në Rr. . . . në Gjakovë, saktësisht në parkingun e diskotekës “. . .”, pa autorizim kanë poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme e në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekusore Nr.02/L-128, dhe atë narkotikun e llojit marihuanë me peshë 0.15 gram dhe kokainë me peshë 0.51 gram, në at mënyrë që pasi të pandehurit më parë e kishin blerë narkotikun duke kontribuar secili me të holla dhe derisa ishin në parkingun e lartcekur me veturën e tipit . . .me targa . . ., janë vërejtur nga policia dhe me rastin e kontrollimit, tek i pandehuri A. gjegjësisht në xhepin e tij është gjetur narkotiku i llojit marihuana, ndërsa poshtë ulëses së pasagjerit janë gjetur tri qese me kokainë, të cilat janë sekuestruar nga policia.

- me çka kanë kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

**Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, nenit 269 par.2-1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe nenit 364 të KPPK-së, -së, të akuzuarve iu shqipton;
DËNIM ME GJOBË**

Të akuzuarit **A. N.**, dënim me gjobë në shumën prej **300 (treqind) euro**, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Të akuzuarës **A. T.**, dënim me gjobë në shumën prej **300 (treqind) euro**, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 43 të KPK-së ,atëherë i njëjti do t'iu zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)euro**.

Detyrohen të akuzuarit që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguajnë shpenzimet në shumë prej nga **20.00 €**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumë prej nga **30.00 €** , në afat prej **15 ditëve** , pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë në.

Gjykata bazuar ne nenin 269 par.3 të KPRK-ës, të akuzuarve iu :

KONFISKOHET substanca narkotike e llojit Marihuanë me peshë neto të përgjithshme 0.15+_0.0001 gram si dhe e llojit Kokainë , me peshë neto 0.51+_0.0001 gram ,të cilat substanca janë sekuestruar me datë 03.05.2022 ,e që është objekt i këtyre veprave penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II nr. 778/22 të datës 18.11.2022 të pranuar në gjykatë me datën 23.11.2022 , ka akuzuar të akuzuarve **A. N.** dhe **A. T.**, që dy nga Gjakova, për shkak të veprave penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge në bashkëkryerje nga neni 269 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, duke propozuar që të njëjtit të shpallen fajtor të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen në pagesën e shpenzimeve procedurale

Gjatë shqyrtimit fillestar gjyqësor të mbajtur me dt. 01.03.2023, prokurori i shtetit Ramadan Koro A.Hasanaj , lexon aktakuzën PP/II nr. **778/22** të dt.18.11.2022, me ç 'rast prokurori deklaroi se duke pasur parasysh se nuk kemi ndonjë aktgjykim të plotfuqishme për të akuzuarit për vepër penale nga neni 269 si dhe duke pasur parasysh se në këtë çështje penale pesha e substancave narkotike nuk kalon 3 gr., andaj kualifikimi i saktë duhet të jetë posedimi i pa autorizuar i substancave narkotike ,psikotrope ose analoge nga neni 269 /2-1 e lidhur me nenin 31 të KPPK-ës, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar .

I akuzuari **A. N.**, gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës se përmirësuar,ky pranim i fajësisë është bërë mënyre vullnetare dhe pa presion duke i kuptuar pasojat dhe favoret mbi pranimin e fajësisë ,me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer ,një kohë kam qene konsumues i rregullt i narkotikeve , premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do te jem me i kujdesshëm duke i kërkuar falje për veprimet e mija ,andaj i propozoi gjykatës te merr parasysh rrethanat lëshueses si pranimi i fajësisë, kërkim faljen nga gjykata për veprimet e mija,

pendimin e shprehur ne gjykatë si dhe gjendjen e dobët ekonomike, faktin se me parë nuk kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

I akuzuari A. T., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me te cilën akuzohet sipas aktakuzës se përmirësuar ,ky pranim i fajësisë është bërë mënyre vullnetare dhe pa presion duke i kuptuar pasojat dhe favoret mbi pranimin e fajësisë ,me pranimin e fajësisë në çdo fazë te procedurës jam penduar për veprën e kryer ,një kohë kam qene konsumues i rregullt i narkotikeve , premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me i kujdesshëm duke i kërkuar falje për veprimet e mija ,andaj i propozoi gjykatës te merr parasysh rrethanat lëshueses si pranimi i fajësisë, kërkim faljen nga gjykata për veprimet e mija, pendimin e shprehur ne gjykatë si dhe gjendjen e dobët ekonomike, faktin se me parë nuk kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit Prokurori i shtetit Ramadan Koro, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu të akuzuarit , për veprën penale me te cilën ngarkohen sipas aktakuzës, pasi qe pranimi është bere në mënyrë e vullnetare dhe pa presion duke i kuptuar edhe me parë pasojat dhe favoret e pranimi te fajësisë ,andaj gjykatës i propozoi qe bëje pranimin e fajësisë dhe te akuzuarave te ju shqiptojë nga një dënim meritor konform ligjit .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari **A.N. dhe A. T.: -me datë 03.05.2022 rreth orës 00:10 minuta në Rr. . . në Gjakovë**, saktësisht në parkingun e diskotekës “. . .”, pa autorizim kanë poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme e në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekusore Nr.02/L-128, dhe atë narkotikun e llojit marihuanë me peshë 0.15 gram dhe kokainë me peshë 0.51 gram, në at mënyrë që pasi të pandehurit më parë e kishin blerë narkotikun duke kontribuar secili me të holla dhe derisa ishin në parkingun e lartcekur me veturën e tipit . . .me targa . . ., janë vërejtur nga policia dhe me rastin e kontrollimit, tek i pandehuri A.gjegjësisht në xhepin e tij është gjetur narkotiku i llojit marihuana, ndërsa poshtë ulëses së pasagjerit janë gjetur tri qese me kokainë, të cilat janë sekuestruar nga policia.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 te KPPK-ës. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se të i akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen te gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpallë fajtor dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tyre.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit . Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarve se të njëjtit janë të moshës relativisht të re , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga të akuzuarit në çdo fazë të procedurës , sjelljen korrekte

të akuzuarve në gjykim, pendimin e tyre , premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 69 të KPRK-së. Kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me gjobë në shumën prej nga **300 (treqind) euro**, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se ky sanksion do të ndikoj tek të akuzuarit që në të ardhmen të mos kryejnë j vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike të substanca narkotike e llojit Marihuanë me peshë neto të përgjithshme 0.15+_0.0001 gram si dhe e llojit Kokainë , me peshë neto 0.51+_0.0001 gram ,e që është objekt i kësaj vepre penale u murr komform nenit 269 par.3 të KPRK-ës .

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej nga 30.00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 449 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së, dhe shpenzimet në shumë prej nga 20.00 € është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimit .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P.nr.488/22 më datë 03.03.2023**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.